

Skema e nëngrantimit është zbatuar në kuadër të projektit **“Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen,,**, mbështetur nga Komisioni Europian

Zhvilluar në bashkëpunim me Instituti i Studimeve Politike dhe Civil Rights Defenders

Organizata zbatuese e nëngrantit: **Youth Center “Perspektiva”**

Zona e zbatimit: Durrës, Elbasan

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është rritja e kapaciteteve dhe fuqizimi i votuesve për herë të parë dhe të rinjve shqiptarë për t'u angazhuar dhe promovuar proceset demokratike dhe për të kontribuar në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të 2021 në bashkitë e Durrësit dhe Elbasanit

Nëpërmjet zbatimit të kësaj nisme, synohet të arrihen objektivat e posaçëm:

1. Rritja e kapacitetit të votuesve për herë të parë dhe të rinjve shqiptarë për t'u përfshirë dhe promovuar procesin demokratik nëpërmjet 2 kurseve të trajnimit (të paktën 60 të rinj), një fushate ndërgjegjësimi (të paktën 1500 të rinj) dhe një sërë aktiviteteve të ngjashme që promovojnë vlerat demokratike, qytetaria e përgjegjshme dhe pjesëmarrja aktive;
2. Mundësimi dhe lehtësimi i përfshirjes së të paktën 30 të rinjve në zonat e Durrësit dhe Elbasanit si monitorues në zgjedhjet parlamentare 2021 përmes një trajnimit *Boot Camp* mbi metodologjinë e OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, koordinimin e ekipeve të monitorimit të të rinjve, mbledhjen dhe raportimin e të dhënave.

Rezultatet të cilat synohen të arrihen nëpërmjet ndërmarrjes së aktiviteteve të planifikuara janë:

1. Rritje e kapaciteteve të votuesve për herë të parë dhe të rinjve nga Elbasani dhe Durrësi për t'u përfshirë dhe promovuar proceset demokratike dhe vlerat e qytetarisë aktive duke marrë pjesë në trajnim;
2. Rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve për vlerat demokratike, qytetarinë e përgjegjshme dhe pjesëmarrjen aktive duke përfituar nga veprimtaritë *online* dhe *offline* të Fushatës Ndërgjegjësuese “Zëri im, Vota ime vlen”;
3. Aftësi dhe njohuri të fituara nga të rinjtë e Elbasanit dhe Durrësit mbi metodologjinë e monitorimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR dhe angazhim si Monitorues Rinor gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2021;
4. Forcimi i bashkëpunimit multilateral mbi mundësimin e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese të të rinjve në procesin demokratik.